



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 722/25 Datë: 20.06.2025

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve, Rregullorja (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Bachelor dhe Master, Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe procesverbalit të mbledhjes 138 të mbajtur më 16.06.2025, mori:

V E N D I M

- I.** Akreditohet programi i studimit të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë, për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2025 – 30 shtator 2028):
 1. *Inxhinieria Minerare, BSc, 240 ECTS (A); me kuotë 20 studente për vit akademik.*
 2. *Zhvillimi i Qëndrueshëm i Minierave, MSc, 60 ECTS (A); me kuotë 10 studente për vit akademik.*
- II.** Numri i studentëve aplikohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- III.** Obligohet Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë që deri më datë 30.09.2025 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- IV.** Obligohet Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë të raportojë dhe arsyetojë në AKA çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit, brenda 90 ditëve. Ndryshimi i bartësve bëhet vetëm me vendim nga KShC.
- V.** Institucioni i Arsimit të Lartë mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VI.** Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë, brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për ri/akreditimin e programeve të studimit me bartësit si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Inxhinieria Minerare, BSc, 240 ECTS (A);</i>	Kemajl Zeqiri Rafet Zeqiri Gzim Ibishi Muhamedin Hetemi
2.	<i>Zhvillimi i Qëndrueshëm i Minierave, MSc, 60 ECTS (A);</i>	Izet Zeqiri

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë.

Bazuar në nenin 16 të Rregullores (AKA) Nr.03/2024 për procedurat e përzgjedhjes, angazhimit dhe kompensimit të ekspertëve të jashtëm dhe Rregulloren (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Bachelori dhe Master (tutje Manualit), ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për këtë program dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit; *Inxhinieria Minerare, BSc, 240 ECTS (A);* vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më 29.04.2025 me këtë përbërje: Regita Bendikene, Badea Ana Cornelia dhe Ervin Rems.

Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar ka konstatuar se : nga shtatë (7) fushat e standardeve të akreditimit ky program është vlerësuar se i përmbush:

- Plotësisht një (1) fusha të standardeve të akreditimit;
- Substancialisht gjashtë (6) fusha të standardeve të akreditimit.

2. Për programin e studimit; *Zhvillimi i Qëndrueshëm i Minierave, MSc, 60 ECTS (A);* vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më 29.04.2025 me këtë përbërje: Regita Bendikene, Badea Ana Cornelia dhe Ervin Rems.

Ekipi i ekspertëve ndërkombëtar ka konstatuar se: nga shtatë (7) fushat e standardeve të akreditimit ky program është vlerësuar se i përmbush:

- Plotësisht një (1) fusha të standardeve të akreditimit;
- Substancialisht gjashtë (6) fusha të standardeve të akreditimit.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 138-të, të mbajtur më datë 16.06.2025, ka shqyrtuar dokumentacionin e Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtroj ankesë në Komisionin e ankesave të AKA, sipas paragrafit 11 të nenit 22 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga dita kur pala është njoftuar për vendimin e KShC-së. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,



Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë